



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 09, datë 15.04.2021

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:**  
**LOTI 1 “RIKONSTRUKSIONI I GODINËS TRE KATËSHE TË SËMUNDJEVE TË**  
**BRENDSHME DHE NDËRTIMI I URËS LIDHËSE ME KORPUSIN QËNDROR” DHE**  
**LOTI 2 “NDËRTIMI I DEPOS SË UJIT TË SPITALIT UNIVERSITAR TË TRAUMËS”,**  
**BASHKIA TIRANË, ME SUBJEKT ZHVILLUES “SPITALI UNIVERSITAR I**  
**TRAUMËS”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues “Spitali Universitar i Traumës”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Loti 1 “Rikonstruksioni i godinës tre katëshe të sëmundjeve të brendshme dhe ndërtimi i urës lidhëse me Korpusin Qëndror” dhe Loti 2 “Ndërtimi i depos së ujit të Spitalit Universitar të Traumës”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues “Spitali Universitar i Traumës”
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

~~OGERTA MANASTIRLIU~~



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

~~LEDIA TOTA~~

